



Datë: 06.05.2025
Numër Protokolli: 3050/2025

A.nr. 431/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.431/2025 të datës 07.03.2025 të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimit/Inspektoratit e Punës, në çështjen juridike “*Vlerësim i Rezultateve në Punë*”, në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.431/2025 e datës 07.03.2025 e parashtruar nga ankuesi A.M.

II. Ndryshohet Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në Punë i datës 21.02.2025 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesin dhe atë nga “*ka nevojë për përmirësim*”, bëhet “*arrin pritshmëritë*”.

III. Ky vendim zëvendëson Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në Punë për ankuesin si në pikën të dispozitivit dhe i njëjti duhet të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunësit civil.

IV. OBLIGOHET Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratit e Punës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, ashtu që këtë vendim të vendosë në dosje të ankuesit nga se konsiderohet vlerësim për vitin 2024.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Nëpunësi civil, A.M (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesi), me datë 07.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është regjistruar me numër protokolli 1496/2025 nën shenjë A.nr.431/2025, kundër formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024.

Sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegjit, me datë 15.04.2025 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli:2501/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.431/2025 të datës 07.03.2025 ia ka vazhduara fatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 20.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Inspektorati i Punës, ndërsa kjo e fundit me datë 16.04.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë lidhur me procedurën në fjalë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën të datës 07.03.2025 të parashtruar nga ankuesi në KPMSHCK; Formulari i vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 20.03.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 16.04.2025; Akt Emërimit e ankuesit të datës 09.02.2012; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022 i datës 30.01.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2023 i datës 24.01.2024; E-mailin e datës 10.12.2024 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 16.01.2025 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 08.01.2025 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 09.10.2023 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 19.12.2024 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 15.10.2024 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur; E-mailin e datës 21.08.2023 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 27.10.2022 dërguar nga H.N për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur.

Kolegji i Këshillit, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ekziston baza ligjore dhe faktike që ankesa e ankuesit A.M, është **e bazuar**, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi sipas aktit të emërimit me numër 01 të datës 09.02.2012 mbanë pozitën e punës “Zv. Kryeinspektorit të Punës për Siguri në Punë” në Inspektoratin e Punës/Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë përmes Formularit të Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2024 i datës 21.02.2025, ankuesin e ka vlerësuar me notën e përgjithshme, Vlerësimi i përgjithshëm: ka nevojë për përmirësime.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2024, pretendon se vlerësim në fjalë është bërë nga eprori i cili është emëruara në mënyrë të kundërligjshëm, çështje kjo vendosur nga KPMSHCK përmes Vendimit Nr.50/2022, ligjshmëria e të cilit është konfirmuara edhe nga instancat gjyqësore, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, andaj përveç tjerash vlerësimi është i kundërligjshëm ngase është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat nga neni 44 të ligjit material pasi që lidhur me vlerësimin tim nuk është marr mendim apo vlerësim paraprak edhe nga kolegët apo vartësit e mi, objektivat e përcaktuara dhe vlerësuara nuk përkojnë me punët që unë mund t'i kryej i pavarur dhe pa marrëveshje me mbikëqyrsin, madje çështjet për të cilat mi ngarkon asnjëherë nuk mi ka deleguar. Po ashtu, vlerësimi është tendencioz, i paarsyeshëm, i një anshëm, dhe se për objektivat për të cilat deklarohet asnjëherë nuk jam pajtuar dhe as që jam njoftuar lidhur me të njëjtat, me kërkesën që Këshilli ta aprovoi ankesën ndërsa të anuloi vlerësimin e kontestuar, kurse të vendos lidhur me vlerësimin sipas viteve paraprake.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendime ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 52 paragrafi 1, 2, 3, 4 dhe 13 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: **“1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunës/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave, 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. **ka nevojë për përmirësim**; 13.5. **e papranueshme**.”**, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës rezulton së ankuesi për periudhën e vitit 2024 lidhur me pjesën e përmbushjes dhe realizimit të objektivave të punës dhe aftësive profesionale, është vlerësuar me notë të përgjithshme: **ka nevojë për përmirësim**.

Duke marr parasysh dispozitat e cekura si më lartë, dhe po ashtu duke marr parasysh provat materiale të lëndës, gjegjësisht formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2024, Kolegji i Këshillit konstaton se sipas vlerësimit të ankuesit për vitin 2024 me notën e përgjithshme **ka nevojë për përmirësim**, rezulton se ankuesi nuk ka arritur të përbush të objektivat e përcaktuara të punës, gjegjësisht nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij, ngase duke marr parasysh dispozitat e Rregullores NR. 26/2024 Për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, gjegjësisht nenin 9 paragrafi 3 nën paragrafi 3.4, përcakton se: **“Ka nevojë për përmirësim”** është vlerësim që tregon se nëpunësi civil nuk ka arritur të përmbushë në mënyrë të plotë pritshmërinë dhe kërkesat për rolin e tij. Ekzistojnë fusha ku kërkohet përmirësim i dukshëm për të arritur nivelin e pritshëm të performancës”.

Pas analizimit të dispozitave të aplikuara ligjore të ligjit material që rregullon çështjen e vlerësimit të rezultateve në punë, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka konstatuar se udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, të njëjtit nuk ia ka përcaktuar objektivat e punës në fillim të vitit 2024, respektivisht është vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 52 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenit 4 paragrafi 1 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë ku përcaktohet se : *“4.1. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunësit civil bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësin, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. Gjatë përcaktimit të objektivave, NjMBNj siguron përfshirjen e trajnimeve të nevojshme për nëpunësin civil në planin individual të tij”*, pasi që Këshilli me rastin e dërgimit të kërkesës për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Inspektorati i Punës, me datë 20.03.2025 ndër të tjerash në cilësi të shkresave të lëndës janë kërkuara, si në vijim: *“Formularin lidhur me përcaktimin dhe pajtueshmërinë e objektivave të përcaktuara për vitin 2024”*, ndërsa në përgjigjen e pranuar të datës 16.04.2025 me provat e lëndës të ofruara nga Njësia e Burimeve Njerëzore, konfirmohet fakti se një parakusht i tillë ligjor nuk është plotësuar, respektivisht del se ankuesit nuk i janë përcaktuar objektiva të punës në mënyrë specifike, të matshme, të arritshme dhe të përcaktuara në kohë, sikurse përcaktohet edhe me dispozitat e paragrafit 3, të nenit 4 të Rregullores Nr.26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë.

Po ashtu, lidhur me pretendimin e palës ankuese, për ligjshmërinë ushtrimit të detyrës së Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, Kolegji i Këshillit thekson faktin se zyrtari i cili e ka nënshkruar formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin, gjegjësisht Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, në këtë pozitë pune është emëruar me mandat katër (4) vjeçar, përmes Vendimit Nr.01/79, të nxjerrë nga mbledhja e datës 25.02.2022, e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes monitorimit të jashtëzakonshëm të bërë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me emërimin e Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës përmes Vendimit Nr.50/2022 të datës 14.07.2022, mbi të cilin akt ishte aprovuar Raporti i Monitorimit të Jashtëzakonshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (*tani e tutje referuar: MFPT*), paraprakisht kishte konstatuar se emërimi i Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, është bërë në kundërshtim me ligjin, çështje e vendosur edhe përmes Aktgjykimit A.nr.1892/2022 të datës 14.04.2023 nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Gjykata e Apelit e Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër AA.nr.354/2023 të datës 08.07.2024 dhe Aktvendimit me numër ARJ.nr.134/2024 të datës 25.09.2024 nga Gjykata Supreme e Kosovës.

Ndër të tjera, përveç të gjeturave të lartcekura Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës arriti në përfundimin se ankuesit, udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë gjatë vitit 2024 ankuesit nuk i ka kërkuar performancë më të mirë, evitim të lëshimeve apo sugjerim që ndërlihet drejtpërsëdrejti me arritjen e objektivave, kurse shumica e shkresave të ofruara nga organi i punësimit, janë të periudhës kohore të vitit 2023 mbi të cilën mbështet edhe lloji apo nota e vlerësimit.

Prandaj, nga se u tha si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, si dhe duke vlerësuar faktin se ankuesi në vlerësimin paraprak sipas Formularit të vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2022 i datës 30.01.2023 ka qenë e vlerësuar me notë të përgjithshme mesatare **4**, apo **“shumë mirë”**, sipas dispozitave të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik, si dhe duke marrë për bazë vendimin e Këshillit A.nr.192/2024 të datës 26.03.2024, përmes të cilit ankuesit i ishte ndryshuar nota e vlerësimit nga **“kënaqshëm ose mjaftueshëm”** në **“mirë”**, për arsyet e dhëna të njëjta sikurse në këtë vendim, Kolegji i Këshillit e ndryshon formularin e vlerësimit të rezultateve të punës së ankuesit, duke vendosur që nota e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024 të jetë **“arrin prishmëritë”** sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ngase organi i punësimit nuk kishte arritur ta mbështesë me fakte të provueshme se mbikëqyrësi nuk i kishte

tërhequr vërejtën apo sugjeruar të njëjten për ngritje të performancës lidhur me arritjen apo realizmin e objektivave, nga lënë të kuptojë se është krijuar përshtypje se veprimet e tij janë në frymën e arritjes së objektivave të punës, për aq kohë sa nga udhëheqësi nuk ka pranuar vërejtje të tilla, andaj mbi këtë bazë si dhe provave të ofruara nga ankuesi, Kolegji i Këshillit vendosi që ankesën e ankuesit të datës 07.03.2025 ta aprovojë si të bazuar.

Tutje, Kolegji i Këshillit thekson faktin se me qëllim të zbatimit të këtij vendimi, Njësia e Burimeve Njerëzore është e obliguar që vendimin e Këshillit A.nr.431/2025 të datës 06.05.2025 ta vendos në dosjen personale të ankuesit sipas përgjegjësisë funksionale që ka në kuptim të dispozitave të ligjit material.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.431/2025, datë 06/05/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Inspektoratit të Punës (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.